



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Programi mësimor
GJUHË SHQIPE
për klasën VII

Shkup, 2023

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	VII (e shtatë)
Temat/fushat e programit mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë dhe komunikim • Letërsi, të shprehurit dhe krijimtari • Njohuri mediatike
Numri i orëve mësimore	4 orë në javë / 144 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë e shkollës, teknologji kompjuterike, printer. • Mjetet dhe burimet për të mësuar: fotografi, ilustrime me figura që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë, plakate, afishe letrare, skema dhe paraqitje të ndryshme nga materiali mësimor panele që ndjekin materialin sipas fushave programore, fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikon, enciklopedi, libra, programe/software edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; • bibliotekë me libra në klasë, biblioteka e shkollës. <p>Shënim: Nëse mësimi realizohet në kabinet, rekomandohet organizim i një këndi të dramës, një këndi artistiko-letrar, një këndi për gazetari, një vendi të përshtatshëm për bibliotekë në klasë.</p>
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe në klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi që ka kryer drejtimin arsimor të programit studimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <p>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike”.</p>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit të dhëna në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore**:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato joletrare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëpusë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medie të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste e mjedise të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);
I-B.3	gjatë leximit të teksteve me përmbajtje dhe me strukturë të ndryshme, zhvillohet shkrim-leximi, formohet një këndvështrim më i gjerë për veten dhe për botën dhe kështu nxitet të shkruarit nga domosdoshmëria dhe me kënaqësi;

I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte;
I-B.5	leximi dhe të shprehurit në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e krijimtarisë dhe të të menduarit kritik;
I-B.6	njohja e gjuhës amtare është baza e të mësuarit dhe përvetësimit të njohurive në të gjitha fushat e tjera (lëndët mësimore);
I-B.7	Njohja e gjuhës amtare është një ndër shtyllat më të rëndësishme të identitetit etnik.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike, Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje dhe Të shprehurit artistik dhe kulturë.**

Njohuri digjitale

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe të instalojë programet që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidh problemet rutinë për funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale;
IV-A.3	të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit, të ruajtjes së sigurt dhe të shpërndarjes së përmbajtjeve në pajisje dhe në rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët, të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plan për hulumtimin dhe zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë do të përdorë TIK-un.
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë rëndësinë e tyre në raport me kërkesën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, t'i analizojë të dhënat dhe t'i prezantojë ato në mënyra të ndryshme duke i respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbejë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojnë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën dixhitale;

IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe i papërshtatshëm i TIK-ut ka kufuzime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut vazhdimisht rriten prandaj duhet të ndiqen dhe të përdoren, por gjithashtu duhet të ketë qëndrim kritik ndaj vërtetësisë, besueshmërisë dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;

Zhvillim personal dhe social

V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;

V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerr është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>	
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të silllet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjyqimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël) në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;

VI-A.17	të analizojë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të zgjedhë burime të besueshme informacioni mbi të cilat do t'i bazojë pikëpamjet e veta;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre.

Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>	
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit;

Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi /nxënësja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e afërt dhe atë të gjerë dhe të analizojë ndërlidhjen dhe varësinë reciproke të tyre;
VIII-A.9	të njohë dhe të shpjegojë se si kultura së cilës i përket (përfshirë traditën dhe fenë) ka ndikuar në formimin e identitetit dhe botëkuptimit të tij/saj;
VIII-A.10	të identifikojë dhe të shqyrojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: GJUHË DHE KOMUNIKIM
Gjithsej: 70 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë gjuhën si sistem shenjash në komunikimin ndërnjerëzor dhe të bëjë dallimin ndërmjet dialektit dhe gjuhës standarde;
2. të shpjegojë historikun e alfabetit të gjuhës shqipe;
3. të shpjegojë rëndësinë e Kongresit të Manastirit;
4. të shpjegojë shmangien e përngjasimeve tingullore;
5. të përdorë drejt intonacionin në fjali të ndryshme sipas qëllimit të thënies;
6. të kuptojë dhe sqarojë domethënien e kategorisë gramatikore të *numrit* dhe të zbatojë drejt format e njëjësit dhe të shumësit tek emrat, mbiemrat, format e përemrave vetorë, si dhe përemrave vetvetorë;
7. të dallojë dhe të shpjegojë trajtat e foljes në mënyrën lidhore
8. të përdorë në mënyrë të drejtë foljet kalimtare që marrin kundrinë të drejtë;
9. të formojë trajta të mënyrës urdhërore dhe të kohës së kryer të mënyrës dëftore (forma veprare dhe joveprare);
10. të dallojë grupin emëror dhe të sqarojë rolin e tij në fjali;
11. të dijë funksionin e gjymtyrëve të fjalisë: të kryefjalës, të kallëzuesit dhe të rrethorëve;
12. të përdorë drejt shenjat e pikësimit gjatë komunikimit me shkrim;
13. t'u përgjigjet pyetjeve, të perifranojë, të citojë dhe të shpjegojë pjesë të një teksti dhe tekstin në tërësi.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Shkenca për gjuhën

- Gjuha si sistem shenjash

(gjuhë natyrore, gjuhë artificiale, gjuhë popullore, gjuhë dialektore, gjuhë standarde; shkrimi ideografik, shkrimi piktografik)

Standardet e vlerësimit:

- Shpjegon gjuhën si sistem njësisht gjuhësore.
- Shpjegon krijimin e gjuhës natyrore dhe gjuhës artificiale.
- Shpjegon veçoritë kryesore të gjuhës popullore.
- Tregon dallimin mes dialektit dhe gjuhës standarde.
- Njeh dialektin dhe gjuhën standarde në komunikimin e përditshëm.

	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon lloje të shkrimeve. • Bën krahasimin mes shkrimit ideografik dhe atij piktografik.
<p>Zhvillimi historik i gjuhës shqipe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Historiku i Alfabetit të gjuhës shqipe (tradita e shkrimit të shqipes, alfabetet latine: <i>alfabeti i "Agimit", alfabeti i "Bashkimit"</i> dhe <i>alfabeti i Stambollit</i>; alfabeti grek dhe alfabeti arab; • Kongresi i Manastirit – 1908 (pjesmarrësit, diskutimet dhe vendimet) • Kongresi i Drejtshkrimit – 1972 (gjuha e folur dhe gjuha e shkruar, procesi i standardizimit të gjuhës shqipe) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan traditën e shkrimit të gjuhës shqipe. • Shpjegon ecurinë dhe rëndësinë e unifikimit të alfabetit të gjuhës shqipe. • Njeh karakteristikat e gjuhës së folur dhe të gjuhës së shkruar. • Shpjegon ecurinë e standardizimit të gjuhës shqipe. • Tregon rëndësinë e standardizimit të gjuhës shqipe. • Shpjegon përdorimin e gjuhës shqipe para Kongresit të Drejtshkrimit. • Shpjegon parimet themelore të gjuhës së standardizuar . • Shpjegon veçoritë e përgjithëshme të periudhës kishtarë sllave. • Tregon veçoritë e përgjithëshme të varianteve të gjuhës shqipe. • Shpjegon disa shmangie më të zakonshme nga standardi i gjuhës shqipe që bëhen në RMV.
<p>Fonetika dhe drejtshkrimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrokja (e hapur e mbyllur) • Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i zanoreve <i>i, y, u</i> • Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i bashkëtingëlloreve <i>r-rr, q-ç, gj-xh,</i> • Theksi dhe intonacioni (theksi i fjalës, theksi i fjalisë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon formimin e rrokjes së hapur dhe rrokjes së mbyllur. • Shkruan dhe i shqipton drejt zanoret <i>i, y, u.</i> • Shqipton dhe i shkruan drejt bashkëtingëlloret <i>r-rr, q-ç, gj-xh.</i> • Jep shembuj të shmangjeve gjatë përdimit të zanoreve <i>i, y, u</i> dhe të bashkëtingëlloreve <i>r-rr, q-ç, gj-xh.</i> • Dallon theksin e fjalës nga theksi i fjalisë. • Thekson në mënyrë të duhur fjalët gjatë lakimit dhe zgjedhimit (zakonisht pa ndryshuar theksin). • Përdor drejt tonin e zërit gjatë intonacionit të fjalisë.
<p>Morfologjia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formimi i emrave të gjinisë femërore (me prapashtesa, me rrënjë të ndryshme) • Formimi i numrit shumës 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh format e emrave të gjinisë femërore dhe jep shembuj për to. • Formon dhe përdor drejt format e shumësit të emrave. • Jep shembuj të mbiemrave cilësorë dhe marrëdhëniorë. • Përdor mbiemra pranë emrave duke i përshtatur në numër gjini dhe rasë.

(temë e njëjtë, mbaresë, ndërrime fonetike, ndërrime fonetike dhe mbaresë)

- Llojet e mbiemrave (cilësorë dhe marrëdhëniorë)
- Përshtatja e mbiemrit me emrin (në numër, gjini dhe rasë)
- Emri - kategoria e rasës (lakimi i parë, i dytë, i tretë dhe i katër)
- Përemrat: lakimi i përemrave vektorë, trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra, bashkimi i trajtave të shkurtra, përemri pronor, lakimi i përemrit pronor
- Numërori (llojet e numërorëve: të parme 0 - 10, të përngjitur 11 - 19, të përbërë 30, 60 ..., shprehje 25, 45, ..., thyesat 1/3)
- Foljet: trajtat (diatezat): veprorë dhe joveprorë; foljet pavetore; mënyra dëfore (koha e kryer, koha më se e kryer, koha e kryer e tejkshuar dhe koha e ardhme e përparme); mënyra urdhërore; format e pashtjelluara të foljes (pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja)
- Ndajfoljet: kuptimi; ndarja e ndajfoljeve sipas kuptimit (mënyre, kohe, vendi, sasi), shkallët e ndajfoljeve (pohore, krahasore dhe sipërore)

- Shpjegon kuptimin e kategorisë gramatikore të rasës dhe i tregon lakimet.
- Njeh trajtat rasore të përemrit vektor dhe i përdor drejt ato.
- Njeh trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave vektorë, bashkimin e trajtave të shkurtra dhe i përdor drejt ato gjatë të folurit dhe të shkruarit.
- Njeh përemrin pronor në tekst dhe e përdor drejt atë gjatë të shkruarit dhe të folurit.
- Dallon trajtat rasore të përemrit pronor dhe i përdor drejt ato.
- Dallon llojet e numërorëve.
- Formon drejt numërorët e përngjitur dhe ato të përbërë.
- Përdor drejt gjininë e numrit tre.
- Zbaton drejt trajtat e numërorëve gjatë të folurit dhe të shkruarit.
- Dallon format vektorë dhe pavetore të foljes.
- Formon trajta veprorë dhe joveprorë të foljes.
- Njeh format e foljeve në kohët e mënyrës dëftore (koha e kryer, koha më se e kryer, koha e kryer e tejkshuar dhe koha e ardhme e përparme).
- Jep shembuj të foljeve kalimtare dhe jokalimtare.
- Formon trajta foljore të mënyrës urdhërore.
- Identifikon dhe përdor në mënyrë të duhur format e pashtjelluara të foljes.
- Dallon kohët e thjeshta dhe ato të përbëra të foljes.
- Formon trajta foljore të së kryerës, të më se të kryerës, të së kryerës së tejkshuar dhe të së ardhmes së përparme.
- Identifikon dhe përdor drejt ndajfoljet, si plotësues të veprimit të foljes në fjali.
- Dallon dhe klasifikon drejt ndajfoljet sipas kuptimit.
- Dallon ndajfoljet e mënyrës prej formave të mbiemrave përkatës në raport me drejtshkrimin (*flet drejt – rrugë e drejtë; hipi lart – tavan i lartë*).
- Përdor drejt format e shkallëve të ndajfoljet e mënyrës dhe ndajfoljet e sasisë.

<p>Sintaksa</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grupi emëror - nocioni, ndërtimi dhe funksionet (kryefjalë, kundrinor, rrethantor) • Fjalja me folje pavetore • Fjalja- gjymtyrët e fjalisë – (gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta); kallëzuesi emëror; kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë; rrethantor 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon grupin emëror dhe e përcakton ndërtimin e tyre. • Bën dallimin në mes grupit emëror dhe fjalisë. • Identifikon fjali me folje pavetore. • Shpjegon (me shembuj) ndërtimin e fjalive me folje pavetore. • Krijon fjali me folje pavetore. • Njeh dhe dallon format e kallëzuesit emëror. • Shpjegon (me shembuj) ndërtimin e kallëzuesit emëror në fjali. • Krijon fjali me kallëzues emëror. • Njeh dhe dallon format e kallëzuesit foljor të thjeshtë dhe të përbërë. • Shpjegon (me shembuj) ndërtimin e kallëzuesit foljor të thjeshtë dhe të përbërë. • Krijon fjali me kallëzues foljor të thjeshtë dhe të përbërë. • Njeh dhe përcakton llojet e kundrinorit në tekst/fjali. • Dallon dhe përcakton llojet e rrethantorëve në tekst/fjali. • Krijon shembuj me lloje të ndryshme të rrethantorëve.
<p>Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i shenjave të pikësimit • Shënimi i fjalëve me shkurtesa: bashkimi i rrokjeve a i shkronjave të para të një togu fjalësh 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor drejt shenjat e pikësimit gjatë të shkruarit. • Gjen dhe përmirëson gabime drejtshkrimore në një tekst të shkruar. • Tregon shembuj të shkurtesave të fjalëve sipas rregullave të caktuara. • Zbaton drejt shkurtesat e fjalëve gjatë të shkruarit.
<ul style="list-style-type: none"> • Të dëgjuarit për të kuptuar • Të lexuarit për të kuptuar: të lexuarit hulumtues dhe të lexuarit informativ • Të shkruarit dhe marrja e/përdorimi i shënimeve gjatë leximit të një teksti 	<ul style="list-style-type: none"> • U përgjigjet pyetjeve në lidhje me informacionin e dhënë në mënyrë eksplicite në një tekst të dëgjuar ose të lexuar. • Parafrazon informacionin/të dhënat nga një tekst i dëgjuar ose i lexuar duke përdorur fjalët e veta. • Shpjegon të dhënat e paraqitura në tabela, grafikone, diagrame dhe harta. • Krijon një raport të shkurtër që përmban tabela, grafikone, diagrame sipas kërkesave konkrete. • Krijon hartë të rrethinës së tij ose të një objekti të njohur, duke shënuar pozicione

konkrete.

- Merr shënime me fjalët kyçe dhe pikat kryesore nga një tekst i lexuar ose i dëgjuar.
- Harton përmbledhje të një teksti të lexuar ose të dëgjuar në bazë të shënimeve të marra më parë.
- Përmbledh në disa fjali (në formë të shkruar ose me gojë) një tekst të dëgjuar ose të lexuar.
- Citon fraza nga një tekst i lexuar dhe shpjegon kuptimin e tyre

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. U jepet një fletë pune me grupe tingujsh, grupe fjalësh dhe fjalish. Në fletën e tyre të punës, të gjithë, nga tingujt duhet të krijojnë fjalë dhe t'i shkruajnë ato. Nga fjalët të ndërtojnë fjali të shkurtra dhe t'i renditin fjalitë në një radhitje që ka kuptim. Më pas nis një diskutim se cilët elementë të gjuhës mund të qëndrojnë në mënyrë të pavarur, si grupohen dhe fitojnë kuptim, pra si radhiten njësitë gjuhësore dhe si strukturohet gjuha si sistem shenjash. Nxënësit udhëhiqen në përfundimin se gjuha është një sistem shenjash të njëjësive që grupohen.
- Nxënësit dëgjojnë shembuj të ndryshëm të përdorimit të gjuhës në formën e saj standarde dhe dialektore. Për shembull, një tregim në dialekt (me regjistrim audio ose të lexuar nga mësuesi), ndonjë bisedë nga komunikimi i përditshëm, një segment të një programi televiziv për fëmijë ku përdoret gjuha e përditshme e nxënësve, fjalim në televizion ose një njoftim për publikun, ndonjë fragment nga një vepër letrare etj. Nxënësit inkurajohen të dallojnë përdorimin e gjuhës në situata të ndryshme të paraqitura dhe të tregojnë ku ndryshon dialekti nga gjuha standarde dhe dallimet i shkruajnë në tabelë në një formë të përmbledhur.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe luajnë një lojë - detektivë. Atyre u jepet një fletë pune me enigmë për një thesar të fshehur dhe u jepet detyrë të dekodojnë mesazhet e shifruara me shkrim ideografik dhe/ose piktografik. Dekodimi bëhet duke përdorur skemat e përgatitura nga mësuesimdhënësi/ja. Enigmat e zgjidhura hapin thesarin që gjenden te mësuesimdhënësi/ja. Në fund të aktivitetit, fituesi e shpjegon mënyrën se si janë krahasuar shenjat në këto shkrime dhe kuptimet e tyre.
- Nxënësit punojnë në grupe me materiale që ua jep mësuesimdhënësi: libra dhe informacione për ecurinë e unifikimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Çdo grupi i jepet detyrë e ndryshme për gjetjen e fakteve nga materiali që u është dhënë: 1. tradita e shkrimit të shqipes me alfabetet latine (p.sh. Formula e pagëzimit (1462), Meshari i Gjon Buzukut (1555) shkruar me alfabetin latin, plotësuar me disa shkronja cirilike, shkrime me alfabetin e "Agimit", me alfabetin e „Bashkimit" dhe me alfabetin e Stambollit); 2. shkrimi me alfabetin grek (p.sh. dëshmia e parë me alfabet grek - „Ungjilli i Pashkëve" ose „Përpjekja e Ungjillit", të shek. XIV); 3. shkrimi me alfabetin arab (p.sh. letërsia e bejtexhinjve); 4. Kongresi i

Manastirit (1908) dhe rëndësia e unifikimit të alfabetit të gjuhës shqipe (p.sh. pjesëmarrësit, diskutimet, vendimet). Informacioni i përgatitur ndahet midis grupeve duke përdorur teknikën *Puzzle* (bashkim i pjesëve të një figure), domethënë secili nxënës e ndërron vendin – nga grupi në të cilin ka hulumtuar, shkon në një grup tjetër. Në grupin ku shkon, pra në grupin e ri, ka 4 nxënës, nga një prej secilit grup që ka hulumtuar 4 kërkesat e dhëna në fillim. Në fund, grupi i ri ndan materialin në një dokument apo afishe (poster) të posaçëm, ku prezantohen alfabetet e ndryshme të traditës së shkrimit të gjuhës shqipe.

- Nxënësve u jepet një fletë letre në të cilën shkruhen karakteristikat e gjuhës së folur dhe të gjuhës së shkruar (p.sh. Gjuha e folur dëgjohet, dëgjuesi është i pranishëm dhe mund të kërkojë sqarime; në të folur njeriu jo gjithnjë ka kohë të përgatitet dhe duhet ta ndërtojë komunikimin në çast; përdoren fjali të paplota. Gjuha e shkruar lexohet, shkruesi duhet ta përfytyrojë lexuesin dhe t'i parashikojë nevojat dhe intaresat e tij për t'i dhënë atij informacionin e duhur; gjuha e shkruar ka përparësi faktorin kohë – shkruesi ka kohë të përgatitet, ta shikojë, korrigjojë dhe rishikojë shkrimin e tij; mendimet shprehen me fjali të plota). Prej nxënësve kërkohet që të shprehen me gojë lidhur me një temë të caktuar e më pas të shkruajnë një tekst të shkurtër po në atë temë. Sipas udhëzimeve të mësimdhënësit/es nxjerrin përfundim se të folurit dhe të shkruarit, me gjithë këto dallime, kanë të njëjtë lëndë të përbashkët – gjuhën dhe të njëjtin qëllim të përbashkët: komunikimin e ideve, informacionit dhe ndjenjave.
- Nxënësit shohin pjesë të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe në slajd/afish/foto. Inkurajohen të thonë të gjitha ato që i dinë për Kongresin e Drjtshkrimit (1972), kurse mësimdhënësi/ja i shkruan informacionet në tabelë duke përdorur teknikën *Kalavesh*. Këtyre informacioneve u ndërlidhen edhe informacionet rreth ecuresë së standardizimit të gjuhës shqipe që i jep mësimdhënësi/ja. Më pas nxënësit i përdorin të gjitha informacionet për të krijuar një tekst për ecurinë e standardizimit të gjuhës shqipe, e që secili nxënës e shkruan vetë.
- Në klasë vendosen afishe (posterë) me ngjarjet më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës shqipe para Kongresit të Drejtshkrimit. Nxënësit diskutojnë për përdorimin e gjuhës shqipe para Kongresit të Drejtshkrimit (Komisinë Letrare Shqipe, Kongresin e Lushnjës...) dhe bashkë me mësimdhënësin/en në fund të orës pasqyrojnë zhvillimet më të rëndësishme të gjuhës shqipe deri në fazën e standardizimit.
- Në tabelë shënohen parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe (parimi fonetik, parimi morfologjik, parimi leksikor-kuptimor, ai historik-tradicional) . Nxënësve u kërkohet të tregojnë se cili është parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Pasi nxënësit do të tregojnë se parimi themelor është parimi fonetik, kjo ilustron me shembuj: në përgjithësi fjalët shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërim.
- Nxënësit ndahen në dy grupe dhe në çdo grup nëpërmjet të teknikës *Harta e të menduarit* paraqitet koncepti i temës variantet (dialektet) e gjuhës shqipe. Çdo grup e paraqet hartën e vet (njëri grup paraqet gegërishten, grupi tjetër toskërishten), kurse mësimdhënësi/ja përmes pyetjeve të synuara pas çdo prezantimi tregon fakte themelore shkencore të cilat nxënësit duhet t'i dinë (ndarja në nëndialekte; ndryshimet ndërmjet dialekteve - fonetike, në leksik, në format gramatikore; ndikimet e ndërsjella mes dialekteve dhe gjuhës standarde).

- Nxënësve u jepen fletë ku janë shkruajtur shmangiet më të zakonshme nga standardi i gjuhës shqipe që bëhen në RMV. Nxënësit i klasifikojnë shmangiet sipas fushave gjuhësore: në planin fonetik (p.sh. *bazen, çokolladë, financa, univerzitet* në vend *basen, çokollatë, finansa, universitet*), në planin morfologjik (*ekipa, plazha, revolti* në vend *ekipi, plazhi, revolta*), në planin sintaksor (*oborri shkollor, Ministria për Arsim* në vend *oborri i shkollës, Ministria e Arsimit*). Çdo shembull shpjegohet dhe në tabelë shkruhet forma e drejtë.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një tekst, fjalët e të cilit nxënësit duhet t'i ndajnë në rrokje. Më pas në tabelë në dy kolona shënohen rrokjet e hapura dhe rrokjet e mbyllura.
- Nxënësve u jepet një tekst me gabime të qëllimshme në përdorimin e zanoreve *i, y* dhe *u*. Detyra e nxënësve është t'i korrigjojnë gabimet, duke i shkruajtur të gjitha përdorimet e gabuara në tabelë. Më pas, pranë formës së gabuar, shkruhet forma e drejtë, në mënyrë që nxënësit ta vërejnë dhe ta regjistrojnë dallimin.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Mësimdhënësi/ja në tabelë shkruan fjali, në të cilat përdor fjalë ku përmbahen dendur bashkëtingëlloret *r-rr, q-ç, gj-xh*. Çdo nxënës i vëren këto bashkëtingëllore dhe i shqipton. Mësimdhënësi/ja tërheq vërejtjen për drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e këtyre bashkëtingëlloreve. Pas kësaj mësimdhënësi u lëshon regjistrime audio ku bashkëtingëlloret *r-rr, q-ç, gj-xh* shqiptohen drejt dhe pastaj fjalët që i përmbajnë këto bashkëtingëllore i shkruan edhe në tabelë. Nxënësit e dëgjojnë me vëmendje shqiptimin e drejtë.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grupi i jepet një fletë pune e cila përmban fjali me fjalë njërrrokëshe dhe shumërrrokëshe. Nxënësit e përcaktojnë ku bie theksi në ato fjalë (në rrokjen e vetme, në rrokjen e dytë nga fundi i fjalës, në rrokjen e fundit, në rrokjen e tretë dhe të katërt nga fundi i fjalës). Më pas fjalët ia shqiptojnë shokut/shoqes duke pasur kujdes për theksimin e drejtë të tyre. Pastaj, nxënësit i shqiptojnë fjalitë duke mbajtur llogari për theksin e fjalisë (theksimi i fjalës së fundit), theksin logjik dhe për theksin emocional.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grupi i jepet një tekst. Nxënësit kanë për detyrë ta lexojnë tekstin dhe të gjejnë emra të gjinisë femërore. I radhisin në tabelë të ndarë në dy kolona – emra që gjininë femërore e kanë formuar me prapashtesa dhe emra që gjininë femërore e kanë formuar me rrënjë të ndryshme. Me ngjyrë të kuqe i nënvizojnë prapashtesat me të cilat është formuar gjinia femërore. Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë disa emra të gjinisë mashkullore dhe nxënësit e tregojnë atë emër në gjininë femërore (p.sh. *mjek, bari > mjeke, bareshë*). Më pas nxënësit i gjejnë emrat në numrin shumës dhe i radhisin në tabelë të ndarë në dy kolona – emra në numrin njëjës dhe emra në numrin shumës. Me ngjyrë të kuqe i shënojnë mbaresat dhe ndërrimet fonetike me të cilat është formuar shumësi. Mësimdhënësi/ja në tabelë shkruan disa emra në numrin njëjës dhe nxënësit e tregojnë formën e shumësit të tyre (*nxënës, student, mik > nxënës, studentë, miq*)
- Nxënësve u jepet një tekst me detyrë të gjejnë mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë. Pasi i gjejnë dhe i veçojnë mbiemrat cilësorë nga ata marrëdhëniorë, nxënësit formojnë një fjali me secilin mbiemër marrëdhënior. Nxënësit i lexojnë fjalitë me zë dhe diskutojnë për përdorimin e

mbiemrit përkatës marrëdhënior.

- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë pune në të cilën fjalitë duhet të plotësohen me trajtat të shkurtra/plota të përemrave vetore. Shembujt e fjalive përmbajnë fjali që janë të përshtatshme për nxënësit dhe që lidhen me realitetin e tyre. Nxënësit i lexojnë shembujt para shokëve të klasës dhe gabimet që vërehen, korrigjohen së bashku.
- Nxënësve u jepet një tekst i shkurtër që përmban përemra pronorë të shkruar në kllapa dhe që janë në rasën emërore (p.sh. *I bleva një libër babait (im). Motrën (jonë) e ftuan në një solemnitet.*) Detyra e nxënësve është që ta shkruajnë përemrin në rasën e duhur në tekst (*I bleva një libër babait tim. Motrën tonë e ftuan në një solemnitet.*). Mësimdhënësi/ja ua tregon tekstin me përdorimin e drejtë të rasave të përemrave pronorë të dhënë në tekst, kurse nxënësit e krahasojnë tekstin e tyre me tekstin që ua ka paraqitur mësimdhënësi/ja dhe sipas nevojës bëjnë korrigjime.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grupi i jepet një fletë pune që përmban disa fjali. Nxënësit i nënvizojnë numërorët dhe flasin për llojin e tyre: të parmë, të përngjitur, të përbërë, shprehje. Atë që kanë mësuar rreth numërorëve e ndajnë përmes shembujve përkatës duke i përdorur numërorët drejt.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë pune me një ilustrim të një numri të caktuar njerëzish (14) që kryejnë një aktivitet/veprim dhe me një ilustrim të një grupi që udhëton diku, në të cilin ka 22 njerëz. Nxënësit duhet të shkruajnë dy fjali për çdo ilustrim, duke i kushtuar vëmendje përdorimit të numrave të përngjitur dhe të atyre të përbërë. Me zbatimin e pyetjeve synuese mësimdhënësi/ja dëgjon shembujt e paraqitur nga nxënësit dhe jep komente për drejtshkrimin e numrave të përngjitur dhe të përbërë.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Atyre u jepen fleta pune ku janë shënuar emra të ndryshëm para të cilëve duhet të vendosin numërorin tre/tri, duke pasur parasyshë gjininë (p.sh. _____ vajza; _____ gurë; _____ male; _____ njerëz; _____ nxënës etj.).
- Nxënësit janë të ndarë në grupe. Tërheqin fleta në të cilat janë të shkruara forma vetore dhe pavetore të foljeve. Secili grup merr udhëzim që të krahasojë format e foljeve që ka tërhequr dhe të shkruajë nga një shembull me to. Secili grup prezanton dhe diskuton për shembujt e vet, ndërsa pyetjet e synuara të mësimdhënësit/es pas çdo prezentimi i udhëzojnë nxënësit në përfundime për të dalluar format vetore nga format pavetore të foljes.
- Nxënësit të ndarë në grupe, marrin fleta pune ku janë shënuar folje. Disa grupe kanë folje në formën veprorë dhe marrin për detyrë t'i kthejnë ato në formën joveprorë, ndërsa grupet tjera kanë folje joveprorë që duhet t'i kthejnë në formën veprorë. Në fund, grupet paraqesin punën e bërë dhe diskutojnë rreth formimit të formave veprorë dhe joveprorë të foljeve.
- Nxënësve, të ndarë në çifte, u jepet për detyrë të shënojnë nga një folje në mënyrën dëftore dhe atë ta paraqesin në forma të caktuara (koha e kryer, koha më se e kryer, koha e kryer e tejshkuar dhe koha e ardhme e përparme). Në dërrasë të zezë vizatohet një tabelë me kolona për

secilë kohë, ku nxënësit paraqesin punën e tyre.

- Nxënësit marrin një teks të shkruar dhe për detyrë kanë të gjejnë foljet kalimtare dhe jokalimtare. Secili prej tyre, në mënyrë individuale në fletore i shkruan foljet në dy kolona: në njërin i shkruan foljet kalimtare dhe në tjetrën ato jokalimtare. Disa nxënës paraqesin detyrën dhe diskutojnë bashkë me mësimdhënësin/en për mënyrën se si arritën të bëjnë dallimin e foljeve kalimtare nga ato jokalimtare.
- Nxënësit punojnë në çifte duke i dhënë detyra njëri-tjetrit: *Më sill ujë! Ma jep lapsin! Mbylle derën! Mos më shiko!* etj. Fjalitë i shënojnë në tabelë duke diskutuar mbi përdorimin e tyre. Arrijnë në përfundimin se në gjuhën shqipe ekziston mënyra urdhërore dhe tregojnë mënyrën se si formohet ajo.
- Nxënësit të ndarë në grupe, marrin nga një listë me folje, identifikojnë vetëm format e pashtjelluara të foljes dhe më pas me to krijojnë fjali. Pas leximit të fjalive, diskutojnë rreth ndërtimit dhe funksionit të tyre.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet nga një fletë pune, në të cilën në njërin anë ka ndajfolje, ndërsa në anën tjetër ka fjali që mund të plotësohen nga një ndajfolje. Detyra e nxënësve është t'i lidhin fjalitë e dhëna me ndajfoljet përkatëse dhe më pas secili nxënës tregon një shembull. Mësimdhënësi/ja e përfundon aktivitetin me një diskutim të fokusuar: çfarë vendi zënë ndajfoljet në fjali, sa e ndryshojnë apo shpjegojnë kuptimin e fjalisë. Përfundimet shkruhen në tabelë.
- Në dërrasën e zezë shënohen disa fjali të ndryshme që përmbajnë ndajfolje, nxënësit i identifikojnë ato dhe i klasifikojnë sipas kuptimit dhe shkallës së tyre. Pastaj diskutojnë rreth funksionit të ndajfoljes në fjali. Në fund bëjnë dallimin mes formës së ndajfoljeve të mënyrës dhe formës së mbiemrave përkatës (*p.sh. flet drejt - rrugë e drejtë; hipi lart - tavan i lartë*).
- Nxënësve u jepen ilustrime ose shohin disa fotografi dhe shkruajnë nga një emër për secilin shembull. Pastaj ata marrin për detyrë që të shpjegojnë dhe të plotësojnë emrin me një numëror, pastaj me një mbiemër, pastaj me një përemër e kështu me radhë. Shembullin e marrë e plotësojnë me një veprim - folje dhe formojnë fjali. Krahasojnë: fjalën e parë nistore - emrin, grupin e fjalëve rreth fjalës së parë të dhënë dhe pastaj fjalinë e plotë. I vërejnë ndryshimet në elementet e gjuhës dhe konkludojnë se çfarë dhe pse duhet të përshtatet në fjali, cilat pjesë janë të pavarura...Ngadalë arrijnë në përfundimin për grupin emëror si element kalimtar mes fjalës dhe fjalisë.
- Nxënësit marrin më shumë shembuj: *Bubullin. Vetëtin. Bën ftohtë. Kështu s'punohet.* etj. Për detyrë kanë të gjejnë kallëzuesin dhe kryerësin e veprimit. Diskutojnë për secilin shembull se kush është kryerësi i veprimit, a ka kryerës apo jo... dhe arrijnë në përfundim se në shembujt e dhënë nuk mund të ketë kryefjalë dhe i përkufizojnë fjalitë pavetore. Në fund, secili nxënës përpigjet të japë shembull.

- Nxënësit marrin dy shembuj, në njërin shembull është përdorur kallëzuesi foljor i thjeshtë dhe në shembullin tjetër kallëzues i përbërë. Nxënësit kanë për detyrë që të nënvizojnë kallëzuesit në dy shembujt dhe të shpjegojnë strukturën e kallëzuesit foljor të thjeshtë dhe të përbërë (ata diskutojnë se si mund të përfaqësohet kallëzuesi i thjeshtë i foljes dhe nga sa folje përbëhet kallëzuesi i foljor i përbërë) Në fund, nxënësit në mënyrë të pavarur krijojnë një shembull që përmban kallëzues foljor të thjeshtë dhe një shembull që përmban kallëzues të përbërë dhe shembujt i prezantojnë para nxënësve të tjerë të klasës.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çift merr një fletë pune ku janë shkruar dy fjali që përmbajnë nga një kallëzues emëror. Detyra e nxënësve është të nënvizojnë kallëzuesit në dy shembujt dhe të shpjegojnë strukturën e kallëzuesit emëror (nxënësit tregojnë si ndërtohet kallëzuesi emëror, e shqyrtojnë këputjen-*jam* kur përdoret në mënyra e në kohë të ndryshme dhe tregojnë se me ç'pjesë të ligjeratës shprehet pjesa emërore). Në fund, nxënësit krijojnë në mënyrë të pavarur nga një fjali që në përbërjen e saj ka një kallëzues emëror. Diskutohen shembujt e paraqitur dhe shkruhen përfundime.
- Nxënësit shkruajnë shembuj - fjali në të cilat duhet të ketë një kryefjalë, një kallëzues dhe një gjymtyrë të fjalisë mbi të cilën bie veprimi i foljes. Pasi shkruajnë fjalitë, mësimdhënësi jep shpjegimë për kundrinorin si pjesë e strukturës së fjalisë. Shembujt shkruhen në tabelë dhe kontrollohet nëse kundrinori në secilën fjali është përcaktuar saktë nga nxënësit dhe në kuadër të rendit të gjymtyrëve në fjali, shpjegohet cili është vendi i zakonshëm i kundrinorit në fjali.
- Nxënësve u jepet detyrë të shkruajnë shembuj në të cilët duhet të ketë informacion se *ku, kur, sa, si, pse* dhe *përse* kryhet veprimi i foljes në fjali. Shembull: *Arta shkruan detyrat e shtëpisë në tavolinë. Ndeshja finale u zhvillua dje. Luli punonte pa pushim. Trimi foli gjatë për lirinë. Hana kishte ardhur këtu për pushime etj.* Secili nga shembujt e dhënë shpjegohet në tabelë.
- Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup merr dy fletë mësimore. Në njërin fletë mësimore ka një tekst me përdorimin e saktë të shenjave të pikësimit dhe në fletën tjetër mësimore ka një tekst me gabime të qëllimshme në lidhje me përdorimin e shenjave të pikësimit. Nxënësve të grupeve u jepet detyrë të gjejnë dhe të nënvizojnë të gjitha shenjat e pikësimit nga dy tekstet. Secili grup diskuton përdorimin e drejtë dhe të gabuar të shenjave të pikësimit dhe kjo përmbledhet në formën e një përfundimi. Grupet prezantojnë punën, japin shpjegimet e duhura për përdorimin e drejtë dhe të gabuar të shenjave të pikësimit dhe në të njëjtën kohë nxënësve u jepet mundësia të korrigjojnë gabimet e tyre dhe të atyre që prezantojnë.
- Nxënësit nxiten të diskutojnë për të bërë një listë të vogël fjalësh që i shkurtojnë gjatë të shkruarit ose fjalë që duhet të përdoren të shkurtuara në fjalime formale ose joformale. Më pas, me ndihmën e pyetjeve udhëzuese dhe shpjegimeve të shkurtra, dalin me rregullat që kanë të bëjnë me shkurtimin e fjalëve të caktuara dhe më pas vënë në dukje fjalët që më shpesh i nënshtrohen shkurtimit. Të njëjtën gjë e vendosin në tabelë si shembuj më të shpeshtë. Nga shembujt e treguar në tabelë, nxënësit hartojnë fjali që pasqyrojnë shkurtimin e saktë të

fjalëve. Disa nxënës shkruajnë shembujt në tabelë dhe japin sqarime për shkurtesën specifike të fjalës së përdorur në fjali.

- Nxënësit dëgjojnë një njoftim për aktivitetet e ardhshme në shkollë, shënojnë dhe ndajnë informacionet e sakta dhe të qarta.
- Nxënësit dëgjojnë/lexojnë një tekst për një fenomen natyror. Ata e thjeshtojnë tekstin me fjalët e tyre dhe e ndajnë atë me të tjerët.
- Nxënësit lexojnë rezultatet e suksesit të klasës për gjysmëvjetor të paraqitura në metodën *Pica* dhe në *Diagram*, i diskutojnë dhe i sqarojnë të dhënat që i ndjekin në tabelen e mençur. Ata përmbledhin bashkë gjithçka çfarë kanë dëgjuar.
- Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe hulumtojnë në mes vete se sa prej tyre vitin e kaluar i kanë lexuar lekturat, sa veta i kanë lexuar gjysmat e lekturave dhe sa kanë lexuar vetëm një lekturë. Në secilin grup organizojnë kush do të shkruajë mbi të dhënat, kush do t'i paraqesë ato të dhëna me metodën *Pica* ose me *Grafik*. Rezultatet ndahen mes nxënësve dhe shqyrtohen bashkë.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe simulojnë një situatë përpara një fatkeqësie të mundshme natyrore. Për planifikimin e evakuimit duhet një hartë e katit të parë të shkollës, hartën e punojnë sipas udhëzimeve të mësimdhënësit dhe secili grup hartën e vet e ndan me të tjerët. Në fund zgjedhet harta më e suksesshme dhe më e qartë.
- Nxënësve u jepet tekst në lidhje me ndonjë temë nga një lëndë tjetër mësimore, ndahen në grupe dhe secili grup ka detyra të ndryshme: të gjejnë dhe të interpretojnë fjalët kyçe, të gjejnë dhe të interpretojnë fraza të rëndësishme, ta përfundojnë tekstin më disa fjali kryesore. Rezultatet e punës ndahen përpara klasës.

Fusha programore: LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Gjithsej: 59 orë

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë dhe të analizojë tekste me autor si dhe tekste të krijimtarisë popullore (legjenda, gojëdhëna, fjalë të urta, bekime, dolli, tregime popullore humoristike, anekdota);
2. të analizojë poezitë epike nëpërmjet të karakteristikave të tyre;
3. të dallojë llojet e teksteve në prozë (përallë, anekdotë, tregim, roman) dhe t'i analizojë ato sipas elementeve karakteristike;
4. të analizojë strukturën e poezive lirike dhe të njohë figurat stilistike në poezi (metafora, hiperbola, apostrofa, gradacioni dhe refreni);
5. të identifikojë karakteristikat e tekstit dramatik;
6. të ritregojë tekste, të rrëfejë ngjarje, me gojë dhe me shkrim në mënyrë kronologjike dhe retrospektive;
7. të shkruajë një tekst në temë që i është dhënë, në temë të panjohur dhe në temë sipas zgjedhjes, duke respektuar rregullat e kompozicionit të

<p>tekstit dhe normat drejtshkrimore;</p> <p>8. të përshkruajë personazhe nga vepra letrare dhe individ, vende konkrete dhe të imagjinuara.</p> <p>9. të dallojë shkrimin kreativ dhe atë të mbështetur në fakte, të dhëna dhe informacione dhe të hartojë tekste të shkurtra të të dyja llojeve.</p> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>10. do të zhvillojë vetëdije për nevojën për të lexuar vepra letrare;</p> <p>11. do të kuptojë dhe pranojë se të menduarit dhe të shkruarit kreativ zhvillohet përmes të lexuarit dhe të të shprehurit.</p>	
Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet e vlerësimit:
<p>Letërsia popullore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gojëdhënat dhe legjendat (miti, legjenda, gojëdhëna, përalla, tregimi realist) • Llojet e shkurtra folklorike (fjalët e urta, bekimet, dollitë, mesazhet dhe urimet) • Tregimi popullor humoristik • Anekdodat 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon karakteristikat e gojëdhënave dhe të legjendave përmes shembujve konkretë. • Krahason legjenda dhe gojëdhëna sipas karakteristikave të tyre dhe jep shembuj. • Bën dallim midis mitit, legjendës, gojëdhënës, përallës dhe tregimit realist. • Krahason përmbajtjet e llojeve të shkurtra të letërsisë popullore, duke i paraqitur ngjashmëritë dhe dallimet. • Njih dhe shpjegon mesazhet dhe urimet në llojet e shkurtra të letërsisë popullore. • Tregon karakteristikat e tregimeve popullore humoristike. • Tregon anekdota: anekdota popullore, anekdota nga jeta e vet dhe anekdota të cilat i ka dëgjuar ose lexuar për disa njerëz të famshëm.
<p>Epika në vargje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këngët epike popullore (rrëfimi epik, përsëritja epike/gjerësia epike, kompozicioni i poezisë epike, personazhe - heronj, attribute të heronjve, tetërrokëshi, figurat stilistike shprehëse - hiperbola, apostrofa, gradacioni, refreni) 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon karakteristikat e këngëve epike popullore. • Bën dallimin mes këngës epike popullore dhe këngës epike artistike. • Gjen mjetet shprehëse stilistike në poezitë/këngët epike dhe shpjegon përdorimin e tyre në një poezi të caktuar.
<p>Lirika</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë thelbësore strukturore të poezisë (vargu, strofa, subjekti lirik, tema, motivi, imazhi poetik, llojet e rrimës: sipas radhitjes - paraqitjes në strofë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njih veçoritë strukturore të poezisë. • Analizon strukturën e një poezie të caktuar lirike dhe përcakton motivin e poezisë. • Përcakton llojin e rrimës sipas renditjes së vargjeve në strofë. • Identifikon imazhet poetike në një poezi të caktuar lirike dhe i mbështet me vargje nga poezia.

<ul style="list-style-type: none"> Analiza e këngëve lirike sipas motivit dhe shprehjes stilistike (motivet, këngët humoristike, himni; mjete shprehëse stilistike: metafora, hiperbola, apostrofa, gradacioni, refreni) 	<ul style="list-style-type: none"> Ilustron përjetimet e imazheve poetike me mjete të ndryshme. Përcakton motive në poezitë lirike dhe i klasifikon poezitë sipas tyre. Njih poezitë humoristike sipas motivit dhe i përcakton elementet karakteristike të tyre. Njih dhe emërton mjetet shprehëse stilistike (rimën, metaforë, apostrofin, refrenin, hiperbolën, gradacionin) në poezitë lirike. Analizon motivin dhe shprehjen stilistike në tekstin e himnit shtetëror.
<p>Epika në prozë</p> <ul style="list-style-type: none"> Elementet e tekstit në prozë (kronologjia e ngjarjeve, fabula, përmbajtja, personazhi, ideja) 	<ul style="list-style-type: none"> Dallon fabulën dhe syzhenë në një vepër të caktuar të prozës epike. Dallon personazhin letrar nga individ. Tregon dhe shpjegon atributet e personazhit në tekstin letrar në prozë. Tregon rolin e personazhit në tekstin letrar në prozë. Gjen ide në tekst letrar të dhënë në prozë. Bën lidhjen e problematikës së tekstit letrar në prozë me realitetin duke përmendur shembuj nga jeta e përditshme.
<p>Romani fantastiko-shkencor</p> <ul style="list-style-type: none"> Personazhi, vendi, koha dhe ideja në romanet fantastiko-shkencore 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon karakteristikat e romanit fantastiko-shkencor që e dallojnë atë nga llojet e tjera të romaneve. Zbulon dhe i përshkruan elementet në një roman të caktuar fantastiko-shkencor (tema, personazhet, përmbajtja, koha, hapësira, ideja).
<p>Drama</p> <ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat e një teksti dramatik (personazhet në dramë, drejtimet e skenës, akti, skena, imazhi, dialogu, monologu, personazhi, veprimi-ngjarja). 	<ul style="list-style-type: none"> Tregon karakteristikat e dramave sipas së cilave ato dallojnë nga llojet e tjera të veprave letrare. Njih karakteristikat e tekstit dramatik në një vepër të caktuar dramatike.
<p>Të shprehurit dhe krijimtaria</p> <ul style="list-style-type: none"> Tregimi dhe ritregimi: tregimi kronologjik dhe retrospektiv; ritregim i një libri, i një ngjarjeje, i një filmi Përshkrimi: i një personazhi letrar (personazh epik, personazh nga një tekst në prozë); i një individ; 	<ul style="list-style-type: none"> Dallon të treguarit kronologjik nga ai retrospektiv dhe tregon shembuj nga një tekst i dhënë letrar. Tregon në mënyrë kronologjike dhe retrospektive një ngjarje të trilluar ose të përjetuar. Ritregon/tregon një vepër letrare të lexuar, një ngjarje të ndjekur, një film artistik/të animuar që ka parë. Përshkruan personazhe – duke paraqitur karakteristikat dhe sjelljet e tyre. Përshkruan një individ nga mjedisi i afërt.

<p>përshkrimi i një vendi sipas përshtypjes nga libri, i një skene <i>fantastike</i> nga libri, i një vendi/krahine të imagjinuar sipas imagjinatës personale.</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkruarja e teksteve në mënyrë të pavarur: kompozicioni dhe gjatësia e tekstit; të shkruarit në një temë të caktuar dhe në një temë të panjohur; të shkruarit sipas motiveve dhe temave nga letërsia; të shkruarit sipas dëshirës personale; të shkruarit kreativ, të shkruarit me fakte, me të dhëna dhe me informacione; tekste praktike 	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan një vend/krahinë që e ka vizituar apo për të cilin ka lexuar ose e imagjionon një të tillë. Shkruan një tekst në një temë të caktuar apo në një temë të panjohur, duke i respektuar rregullat për kompozicionin e tekstit dhe për gjatësinë e kërkuar të tekstit. Shkruan krijime në prozë dhe krijime poetike sipas motiveve dhe temave nga tekste letrare të lexuara. Bën dallimin midis teksteve me shprehje artistike dhe teksteve të bazuara në fakte, në të dhëna dhe në informacione. Harton tekste të shkurtra, në të cilat shpreh mendime të mbështetura në fakte dhe të dhëna. Harton udhëzime të shkurtra, përshkrime teknike dhe reklama. Shkruan në mënyrë kreative në temë të caktuar ose në temë sipas zgjedhjes duke përdorur mjete shprehëse artistike . Respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit të një teksti.
---	---

Примери на активности:

(Примерите главно обединуваат повеќе стандарди за оценување од ista содржина што може да се реализираат во повеќе часови. Дадените примери може да послужат како модел за креирање нови активности за истите стандарди или за другите кои не се опфатени со нив.)

- Nxënësit dëgjojnë legjenda dhe gojëdhëna që u referohen disa vendeve ose gjërave që janë të njohura për ta, p.sh. “Gojëdhëna e liqenit të Ohrit”, “Legjenda e plakës së prillit”, Legjenda e Rozafës”, etj. Pas pyetjeve udhëzuese, ata bëjnë një plan për përmbajtjen, e definojnë temën, personazhet dhe rrethanat në të cilat zhvillohen ngjarjet. Diskutimi përfundimtar çon në përcaktimin e gojëdhënave dhe legjendave si forma folklorike në prozë që kanë gjurmë mitesh, përmbajtje fantastike, ngjarje e personazhe dhe në to në mënyrë popullore paraqitet natyra dhe dukuritë në te. Përmes teknikës së diagramit të Venit paraqesin karakteristikat e përbashkëta si dhe dallimet mes gojëdhënave dhe legjendave.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup bën një simulim të një ngjarjeje ose ceremonie, secili merr një rol të caktuar: p.sh. Dasma: dhëndri, nusja, nëna e nuses... dhe kumbari. Kumbari duhet të bëjë një doli për nder të porsamartuarve. Grupi e shkruan drollinë dhe një nga nxënësit në rolin e kumbarës e lexon. Dy grupe të tjera të nxënësve shkruajnë bekime ose urime për miqtë ose anëtarët e familjes së tyre. Ata mund të dizajnojnë dhe dekorojnë kartolina të personalizuar me bekimet ose dëshirat e tyre të shkruara brenda. Të gjitha grupet në fund shikojnë video të shkurtra

të regjistruara me njerëz të kombësisë shqiptare, maqedone, turke, boshnjake, serbe, rome dhe vllahe duke bërë dollari, duke shprehur mirënjohje me bekime. Të gjitha këto i shkruajnë në fletore dhe përpiqen t'i shprehin.

- Nxënësit dëgjojnë një tregim humoristik dhe në mënyrë të pavarur bëjnë pyetje për përmbajtjen, duke zbuluar veçoritë humoristike të tregimit. Pyetjet që i kanë shkruar, i parashtrajnë dhe u përgjigjen në çifte.
- Nxënësit me teknikën *Klasa së përmbysur* kanë për detyrë të gjejnë ose shkruajnë një anekdotë nga/për një person i/të famshëm. Në klasë, lexojnë anekdotat që i gjejnë. Gjithashtu, mund të ndajnë një anekdotë që rrjedh nga mjedisi ose familja e tyre. Në fund të orës së mësimin, bisedojnë për disa nga karakteristikat më të rëndësishme të anekdotave (ngjarje interesante, mendjemprehsinë e personazheve, paparashikueshmërinë e ngjarjeve).
- Nxënësit lexojnë një këngë epike popullore në të cilën këndohet të bëmat heroike të Gjergj Elez Alisë, komentojnë përmbajtjen e saj, elementet karakteristike me ndihmën e pyetjeve orientuese. Në një fletë mësimore, ata marrin tiparet stilistike të këngës epike dhe përpiqen t'i gjejnë ato në tekst. Puna e kryer paraqitet para gjithë klasës.
- Nxënësit punojnë të pavarur, lexojnë poezi lirike. Mësimdhënësi bën pyetje për përmbajtjen e këngës, diskutohet për vargje konkrete dhe shpjegohet kuptimi i tyre si dhe imazhet poetike. Në përputhje me diskutimin, bëhet plani, të cilin nxënësit e krijojnë të pavarur: llojet e vargjeve dhe strofave, tema, motivi. (Gjatë përcaktimit të motiveve dhe ideve, mësimdhënësi i motivon nxënësit të shkruajnë atë që kanë kuptuar dhe nuk insiston që përgjigjet të jenë të nivelit të definicioneve). E shkruara ndahet para klasës dhe bëhet një diskutim përmbyllës rreth këngës.
- Nxënësit në mënyrë të pavarur lexojnë poezi. Mësimdhënësi në të ka shënuar disa fjalë kyçe. Nga fjalët e shënuara nxënësit perceptojnë motivin/frymëzimin për poezinë. Më pas përcaktojnë rimën sipas renditjes së vargjeve në strofë: rimë e puthur, rimë e kryqëzuara, rimë e alternuar. Puna e kryer paraqitet para gjithë klasës.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, lexojnë poezi dhe më pas vizualizojnë vargjet: zgjedhin një imazh poetik dhe krijojnë paraqitje vizuale të vargjeve të saja. Mund të vizatojnë ose krijojnë një kolazh për të ilustruar secilin varg veç e veç. Inkurajohen të përfshijnë elementë që pasqyrojnë disponimin në tekst. Më pas nxënësit vazhdojnë të punojnë në çift. Thonë pesë fjalë që lidhen me paraqitjen vizuale, dhe më pas pesë të tjera që rimojnë me to. Nga fjalët e rimuara krijojnë një strofë për të cilën vendosin vetë se ku ta vendosin rimën. Lexojnë para të gjithëve, duke treguar se çfarë rime kanë përdorur sipas vendit në strofë.
- Nxënësit ndahen në grupe aq sa ka strofa në një poezi. Secili grup merr copa të ndryshme gazetash. Duhet të zgjedhin ilustrime nga gazetatat për t'i ngjitur në një fletë të bardhë dhe të krijojnë një kolazh që do të përfaqësojë strofën/imazhin poetik që duhet të ilustrojnë. Secili grup shpjegon pse

zgjodhën pikërisht ato ilustrime.

- Nxënësit punojnë në grupe, marrin nga një strofë të poezisë të cilën e punon e gjithë klasa. Secili grup duhet të krijojë një tingull/të zgjedhë një melodi që e dinjë dhe që do të përfaqësojë strofën që kanë, ose më saktë imazhet poetike të asaj strofe.
- Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup merr një poezi me motiv të ndryshëm dhe detyra e grupeve është të bëjnë një përshkrim tematik në një fletë me fjalë, me thënie, me fjali, me tregime, me ngjyra, me çfarëdo që tu vijë në mendje, por kjo do të lidhet me motivin që kanë marrë. Puna e bërë u prezantohet gjithë klasës, duke u shpjeguar se cili është motivi në poezinë që kanë lexuar.
- Nxënësit lexojnë poezi nga përshkrimi i poetëve shqiptarë që shkruajnë poezi me motive humoristike (Çajupi, Ali Asllani). Kërkojnë elementet humoristike në poezi dhe diskutojnë për to. Më pas krahasojnë humorin e përdorur në poezinë humoristike, anekdotën dhe tregimet humoristike. Konkluzionet shkruhen në tabelë.
- Nxënësit e ndëgjojnë himnin e vendit të tyre, dhe pastaj marrin një fletë pyetjesh dhe bëjnë analizë të përmbajtjes. (Ora mund të integrohet me arsim muzikor dhe të bëhet orë e ndëgjimit të muzikës në të cilën nxënësit do të kenë mundësi ta ndëgjojnë himnet e vendeve të ndryshme të botës). Në fund, nxënësit e thonë himnin përmendësh.
- Nxënësit janë të ndarë në grupe. Grupet kanë detyra të ndryshme: (1) të rendisin kafshët sipas madhësisë, nga më e vogla te më e madhja (miu, macja, dhia, kali, elefanti, gjirafa), (2) të rendisin fjalët sipas numrit të shkronjave që përmbajnë, (3) të rendisin pesë pyetje sipas nivelit të vështirësisë në lidhje me poezinë që punojnë në klasë ose me një tregim të shkurtër. Nga aktiviteti, ata kuptojnë se detyra e tyre është t'i rregullojnë gjërat sikur të ishin në shkallë. Më pas lexojnë poezinë "Gjeniu i anijes" të Lazgush Poradecit dhe njohin figurën stilistike të gradacionit, të cilën e shpjegojnë me vargje konkrete.
- Nxënësit marrin informacion të gatshëm për metaforën - figurë që krahason dy gjëra të palidhura në dukje për të krijuar një imazh ose kuptim të gjallë dhe duke i dhënë kuptim krejtësisht të ri të zakonshmes. Më pas, nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një listë nocionesh (p.sh. *dashuri, lumturi, frikë, guxim*). Për çdo nocion, ata duhet krijojnë më të paktën tre metafora krijuese dhe unike për të përshkruar subjektin ose nocionin e zgjedhur. Më pas i lexojnë shembujt dhe diskutojnë rreth metaforës.
- Nxënësit imagjinojnë një personazh nga e kaluara ose një personazh të famshëm me të cilin nuk kanë mundësi të flasin personalisht dhe duan t'i pyesin ose t'i tregojnë diçka. Në fletore shënohet fjalimi drejtuar atij personi dhe më pas lexohet. Mësimdhënësi/sja gjatë diskutimit aktivitetin e drejton në përcaktimin e termit apostrof, respektivisht mjetit shprehës stilistik, apostrofin. Në ecurinë e mëtejshme të aktivitetit lexojnë një poezi me mjetet shprehëse stilistike-apostrofin dhe bëjnë analizë.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, zgjedhin një këngë nga një këngëtar dhe shkruajnë tekstin e këngës. Më pas, sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, identifikojnë refrenin në këngë dhe ua prezantojnë të tjerëve. Përmes një diskutimi të hapur vijnë në përfundim se për çfarë përdoret refreni.
- Nxënësit marrin shembuj të llojit: *Nuk të kam parë gati njëqind vite; Jeni vonuar përjetësisht; Sot kam 500 punë*; etj. dhe diskutojnë për kuptimin e tyre: sa të vërteta ka në thëniet dhe çfarë nënkuptojnë ato. Ata përcaktojnë nocionin hiperbolë dhe më pas e kërkojnë në fragmente të veçanta nga poezitë (epike, kushtuar forcës së Mujit, etj.).
- Nxënësit ndahen në 5 grupe. Secili grup merr një këngë, detyra e tyre është ta analizojnë atë. Plani është i shkruar në tabelë. Grupet fillojnë të shkruajnë, secili me ngjyrë të ndryshme stilolapsi (për t'i dalluar) çdo 5-6 minuta mësimdhënësjka thotë NDAL dhe grupi i shkëmben poezitë dhe analizat me grupin tjetër, të cilat i bëjnë në një fletë letre. Kështu kjo shkon 5 herë, derisa analiza të kthehet në grupin fillestar. Më pas lexohen poezitë dhe analizat. Analiza konsiston në gjetjen e: motivit, strofës, imazheve poetike, subjektit lirik dhe mjeteve shprehëse stilistike. Secila prej këngëve në vete përmban një nga mjetet shprehëse stilistike (metafora, hiperbola, apostrofa, gradacioni, refreni).
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një tekst. Lexojnë tekstin dhe prej tij i ndajnë ngjarjet që përshkruhen dhe i shkruajnë ato në copa të vogla letre. Ngjarjet në tekst i rregullojnë sipas kronologjisë së autorit – *përmbajtjen (syzhenë)*, pastaj i rregullojnë ato sipas kronologjisë kohore (logjike) të ngjarjes, nga e pari tek e fundit dhe kështu arrijnë deri te fabula e tekstit. Grupet prezantojnë detyrat dhe arrijnë në përfundime për nocionet *përmbajtje (syzhe) dhe fabul*.
- Nxënësit punojnë individualisht. Çdo nxënës duhet të përshkruajë me 5-6 fjali një individ (burrë apo grua) nga jeta e përditshme, sipas përzgjedhjes së tij. Disa nxënës paraqesin atë që kanë shkruar. Më pas, çdo nxënës duhet të përshkruajë individualisht një personazh nga një vepër letrare, i cili nuk është e patjetër të jetë individ por mund të jetë një kafshë, një bimë apo një krijesë e imagjinuar. Disa nxënës të tjerë paraqesin atë që kanë shkruar. Diskutohet për dallimet midis një individi dhe një personazhi. Më pas nxënësit, të ndarë në grupe, shkruajnë në dërrasë konkluzionet për personazhin dhe për individin përmes të cilave përshkruhen këto nocione.
- Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup merr një tekst. Ata përcaktojnë personazhin kryesor në tekst dhe më pas gjejnë dhe shkruajnë karakteristikat (atributet) e tij, pastaj nxjerrin përfundime bazuar në disa elementë të ndërtimit të attributeve të personazhit që janë të shkruara në tabelë: 1. Çfarë thotë personazhi për veten e tij?; 2. Çfarë bën personazhi dhe si vepron ai?; 3. Çfarë thonë personazhet e tjerë për të dhe si sillen?; 4. Çfarë thotë rrëfimtari për personazhin?; 5. Çfarë përshkrimesh të personazhit ka në tekst?
- Nxënësit pasi lexojnë tekstin në të cilin trajtohen tema dhe motive konkrete (miqësia, xhelozia, zilia, trishtimi...) diskutojnë për ngjarje dhe ndjenja

të njëjta ose të ngjashme, si dhe momentet që i lidhin ato, nga njëra anë me tekstin dhe nga ana tjetër me situatat jetësore në të cilat u gjenden. Nga teksti e veçojnë personazhin kryesor, përcaktojnë se çfarë do të arrijë ai personazh dhe çfarë dëshiron dhe më pas përcaktojnë se cilët nga personazhet tjerë e ndihmuan apo kundërshtuan atë që mos të arrijë atë që dëshiron.

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Çdo nxënës plotëson Ditar me shënime të dyfishtë që është i ndarë në dy kolona. Në kolonën e parë ka pyetje, shembuj, citate të përgatitura nga mësimdhënësi/ja, të cilat i referohen temës, personazheve, përmbajtjes, kohës, hapësirës, idesë etj. në një roman fantastiko-shkencor, ndërsa në kolonën e dytë nxënësi plotëson duke u përgjigjur, komentuar dhe duke dhënë konkluzione.
- Nxënësit në mënyrë individuale duhet të tregojnë atë që i ka ndodhur në ditën aktuale, sipas një rendi kronologjik - nga mëngjesi deri në momentin e rrëfimit. Më pas tregojnë ngjarje nga jeta e tyre. Nxënësit mund të sjellin edhe foto nga albumi i tyre (në moshë të ndryshme) të cilat i përziejnë dhe tregojnë për to. Më pas i rregullojnë fotot sipas kronologjisë së ngjarjeve. Diskutohen nocionet e të treguarit kronologjik dhe retrospektiv. Më pas nxënësit në çifte krijojnë diagramin e Venit duke i krahasuar këto nocione. Nxënësit në grup, në tekste të ndryshme zbulojnë dhe përmendin shembuj të të treguarit kronologjik dhe retrospektiv.
- Duke përdorur teknikën *Ndal lëvizjen (stop motion)* në tabletat e shkollës, ku është instaluar aplikacioni (*Stop motion animation movie*), nxënësit në grupe krijojnë video të animuara. Paraprakisht, grupet krijojnë tregime dhe përgatisin materiale për përgatitjen e videos. Pasi të përgatitet videoja, e prezantojnë para grupeve tjera duke e treguar ngjarjen. Pastaj të njëjtin tregim e ritregojnë në mënyrë individuale.
- Nxënësit në mënyrë të pavarur, tregojnë ndonjë ngjarje që kanë vizituar (kulturore, sportive, humanitare) duke respektuar rregullat për kompozicionin e tekstit si dhe gjatësinë e kërkuar përkatëse.
- Nxënësve rikujtohen në lektyrën e fundit. Ata kujtojnë një rajon ose vend të caktuar që u ka lënë një përshtypje të veçantë. E përshkruajnë atë dhe e lexojnë në klasë. (Mësimdhënësi mund të përgatisë citate dhe t'i postojë në tabelën e mençur për kujtesë dhe motivim).
- Nxënësit tërheqin një fletë nga një enë qelqi në të cilën janë vendosura tema të shumta për zgjedhje. Secili nxënës thotë nga një fjalë, që e para i vjen ndërmend për temën e zgjedhur dhe e shkruan atë në tabelë. Më pas nxënësit duhet të shkruajnë një hartim me shkrim për një temë të zgjedhur, në mënyrë që të përdorin dhe të lidhin të gjitha fjalët nga tabela në një tërësi logjike dhe kuptimplotë. Gjatë të shkruarit, nxënësit duhet të respektojnë rregullat për kompozicionin e tekstit (hyrja, pjesa kryesore dhe përfundimtare) dhe t'i përmbahen përfshirjes prej 150-170 fjalësh.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Çdo nxënës interpreton dhe paraqet një tekst letrar që i ka lënë përshtypjen më të fortë. Shpjegon përjetimin e vet të asaj që lexohet duke përdorur asociacione të ndryshme p.sh. ngjyrë, aromë, shije, tingull (p.sh. në çfarë ngjyre të asocion teksti

dhe pse? Çfarë aroma ngjall tek ai? A mund ta përngjajë me një shije të caktuar? Shpreh qëndrim pozitiv ose negativ për përmbajtjen, për një personazh ose për një pjesë të tekstit dhe jep shpjegim duke mbrojtur qëndrimin e tij. Nxënësit e tjerë marrin pjesë në diskutim dhe shprehin mendimet e tyre.

- Nxënësit tregojnë sipas planit dhe udhëzimeve të përcaktuara më parë në tabelë, një temë të zgjedhur. Përshkrimi zhvillohet përmes një loje me top. Për shembull, nxënësi i parë që ka topin e fillon tregimin me një deri në dy fjali. Më pas ia kalon topin një nxënësi tjetër dhe ai e vazhdon tregimin me një deri në dy fjali të tjera. Topi u shkon të gjithë nxënësve të klasës dhe secili nxënës duhet të vazhdojë tregimin derisa i fundit ta përfundojë atë. Historia e treguar më pas shkruhet dhe paraqitet si produkti përfundimtar i aktivitetit kreativ.
- Në orën mësimore nxënësit sjellin udhëzime për përdorim të ilaçeve, të aparateve, të lojërave të ndryshme, etj. Mësimdhënësi/sja zgjedh disa nga udhëzimet dhe i ndan nxënësit në grupe. Secili grup duhet të lexojë tekstin dhe të gjejë fjalët e panjohura. Më pas nxirret një pjesë e udhëzimit dhe lexohet para klasës. Diskutohet edhe stili i të shkruarit dhe informacionet që mund të nxirren prej tij. Secili prej nxënësve në fletore shkruan informacionet nga teksti dhe më pas i lexon ato. Në pjesën e dytë të orës, nxënësit në grup shkruajnë një udhëzim për diçka për të cilën do të bien dakord të gjithë.

Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE

Gjithsej: 15 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të identifikojë dhe të shpjegojë dezinformatat dhe manipulimet në hapësirën mediatike;
2. të identifikojë rreziqet gjatë komunikimit në rrjetet sociale;
3. të vërejë pasojat e ndikimit të rrjeteve sociale në formimin e imazhit për trupin;
4. të bëjë analizë të thjeshtë të përmbajtjeve mediatike.

Nxënësi /nxënësja do ta zhvillojë vetëdije:

5. për pasojat nga përhapja e dezinformatave dhe përdorimi i manipulimeve në media;
6. për rrezikun potencial të mediave sociale për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none"> Dezinformime dhe manipulime (informacione të gabuara /dezinformime dhe informacione të dëmshme/malinformacione; dezinformata vizuale, manipulimi emocional) 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon llojet e ndryshme të informacioneve manipuluese që publikohen në hapësirën mediatike. Tregon shembuj të manipulimit me përmbajtje vizuale. Shpjegon përmes shembujve se si përmbajtjet vizuale përdoren për manipulim emocional.
<ul style="list-style-type: none"> Rreziqet në rrjetet sociale (ruajtja e të dhënave personale, reklamimi i fshehur, profili i rrejshëm, robot i rrjeteve sociale (<i>bot</i>)) 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon mënyrat e mbrojtjes së të dhënave personale <i>online</i>. Njeh reklamimin e fshehur në përmbajtje të ndryshme mediatike. Shpjegon se si të identifikohet profili i rremë në rrjetet sociale. Tregon veçoritë e robotëve të rrjeteve sociale (<i>bot-ëve</i>). Identifikon shenjat më të zakonshme të profileve të rreme dhe të robotëve (<i>bot-ëve</i>) në rrjetet sociale.
<ul style="list-style-type: none"> Mediat sociale dhe imazhi për trupin 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon, përmes shembujve, se si prezantimi i trupit të mashkullit dhe i trupit të femrës në mediat sociale ndikon në formimin e imazhit për trupin. Shpjegon si imazhi për trupin „ideal” i prezantuar në mediat sociale ndikon në vetëbesimin dhe mirëqenien e të rinjve. Tregon strategji të ndryshme për përballimin e presionit që paraqesin mediat në lidhje me imazhin e trupit.
<ul style="list-style-type: none"> Përmbajtjet mediatike për informacion dhe për bindje (raportimi mediatik, opinioni, reklama, reklamimi social, marrëdhëniet me publikun, propaganda) Analiza e përmbajtjeve mediatike (përbërësit e përmbajtjes mediatike, qëllimi i mesazhit mediatik, teknikat e tërheqjes së vëmendjes) 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon përmbajtjet mediatike që kanë për qëllim informacionin (raportim mediatik). Dallon llojet e ndryshme të përmbajtjeve mediatike që kanë për qëllim bindjen (opinion, reklamë, reklamë sociale, marrëdhënie me publikun, propagandë). Zbulon se kush e ka krijuar përmbajtjen mediatike dhe për çfarë qëllimi. Shpjegon komponentët e përmbajtjes mediatike (fjalët, muzika, ngjyrat, lëvizjet, këndi i kamerës etj.) dhe si ata kontribuojnë në arritjen e qëllimit të mesazhit mediatik. Identifikon se cilat teknika për tërheqjen e vëmendjes janë përdorur në përmbajtjen mediatike. Shpjegon përmes shembujve se si bindjet, interesat dhe përvojat e njerëzve ndikojnë në interpretimin e përmbajtjes mediatike.

- Njeh se cilat vlera dhe këndvështrime janë përfshirë në mesazhin e dhënë mediatik dhe cilat nuk janë përfshirë.
- Njeh përmbajtje propaganduese dhe manipuluese në mesazhet mediatike.

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)

- Nxënësit ndahen në 3 grupe, secili grup merr tekst të ndryshëm të përgatitur nga mësimdhënësi/ja. Njëri tekst përmban dezinformata, i dyti malinformata dhe i treti misinformata. Në tabelë mësimdhënësi/ja jep shpjegim për nocionet *dezinformata*, *malinformata*, *misinformata* dhe të njëjtat duhet t'i njohin në shembuj konkret, nëse janë dhe pse janë dezinformata. Përfundimet nga të lexuarit dhe analizën e teksteve grupet i ndajnë para të tjerëve klasës. Prezantimet pasohen nga një diskutim i përbashkët për të përmbyllur informacionet kryesore për malinformata dhe për misinformata. (Shembull për misinformatat - teksti që i referohet një ekskursioni që tashmë është realizuar dhe tregon vendndodhjen dhe kohën në të cilën është realizuar dhe e njëjta është vendosur në faqen zyrtare të shkollës. Informacioni nuk përmban informata të saktë për vendin apo për kohën por nuk ka asnjë qëllim të keq dhe nuk janë të gabuara qëllimisht. Shembull për malinformatat - gazeta e shkollës ka publikuar foton e kapitenit të skuadrës së shkollës për futboll duke pirë cigare në oborrin e shkollës. Informacioni i prish reputacionin e kapitenit dhe nuk ka rëndësi për publikun.)
- Nxënësit të ndarë në grupe kanë për detyrë të gjejnë një manipulim në përmbajtjen vizuale në faqet e rekomanduara nga mësimdhënësi/ja (për shembull, një tekst për qentë endacakë i ndjekur nga një fotografi të njerëzve me plagë që nuk duket se janë shkaktuar nga kafshimi me qëllim që qentë të paraqiten si të rrezikshme për sigurinë e njerëzve). Më pas zhvillohet një diskutim përmes pyetjeve: Pse është publikuar ky informacion? Kush qëndron pas këtij informacioni? Çfarë synohet të nxit të marrësi i informacionit? Në fund, konstatohet se përmbajtja vizuale mund të manipulohet lehtësisht – të shkaktojë reagime emocionale në publik për të arritur ndonjë qëllim të “fshehur”.
- Mësimdhënësi/ja shpjegon se të dhënat personale nuk duhet të ndahen me të gjithë kur komunikoni në internet po ashtu si edhe në jetën reale – ato duhet të jenë të mbrojtura dhe të paarrishme për të gjithë, përveç atyre të cilëve u besojmë që të mos i keqpërdorin. Më pas, përmes stuhisë së ideve, nxënësit tregojnë se çfarë mendojnë dhe nënkuptojnë me të dhëna personale (për shembull, emri, mosha, adresa, shkolla, numri i telefonit) dhe më pas diskutojnë: (1) pse është e rëndësishme të mbrohen të dhënat personale dhe (2) si të mbrohen ato. Përmes diskutimit, nxirren disa rregulla bazë të privatësisë në internet, si mos shpërndarja e informatave personale me të panjohur, mos postimi i informacioneve sensitive në

internet dhe mos shpërndarja e fjalëkalimeve. Gjatë diskutimit, mësuesi thekson rëndësinë e komunikimit të hapur me prindërit/kujdestarët ose të rriturit e tjerë të besuar, për përvojat e tyre në internet, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndonjë shqetësim apo incident të komunikimit në internet. Në fund, nxënësit, të ndarë në grupe, diskutojnë se si ata konkretisht do të vepronin në situata të ndryshme online për të mbrojtur të dhënat e tyre dhe vendimet që marrin i ndajnë me të gjithë.

- Mësimdhënësi/ja paraqet një video në të cilën një ndikues flet se si një produkt e ndihmoi atë të dukej mirë. Në një diskutim të hapur me nxënësit, përmes pyetjeve të bëra nga mësuesi, nxënësit zbulojnë mesazhin e fshehur reklamues (duket sikur ndikuesi flet për përvojat e tij, por në fakt, ai reklamon produktin). Nxënësit ndahen në grupe me detyrë që të gjejnë shembuj të tjerë të ngjashëm të situatave të reklamimit të fshehur në internet dhe ua prezantojnë të tjerëve. Më pas, Mësimdhënësi/ja paraqet një insert nga një ndeshje sportive me sportistë më të mirë (p.sh. një ndeshje tenisi) dhe në diskutim nxënësit zbulojnë se çfarë reklame të fshehtë është e pranishme (p.sh., përmes rrobave, atleteve, rekuizitësve, pijeve), pas së cilës, në të njëjtat grupe, ata gjejnë shembuj të ngjashëm në internet dhe ua prezantojnë të tjerëve. Në fund, zhvillohet një diskutim në të cilin konstatohet se shumë shpesh reklamat nuk janë të dukshme, por maskohen në përmbajtje të tjera, gjë që e vështirëson njohjen e tyre dhe ndikon në konsumin e produkteve të reklamuar.
- Mësimdhënësi/ja shpjegon se në internet dhe në rrjetet sociale, përveç profileve reale (të krijuara dhe të menaxhuara nga persona realë), ka edhe profile false (nuk i përkasin personave realë dhe janë krijuar për qëllime mashtruese). Më pas ai u paraqet nxënësve një shembull të një profili real në media sociale, të një personi të famshëm dhe drejton një diskutim se si të dallohet nëse një profil i caktuar është i vërtetë (nëpërmjet shenjave të tilla si: fotot personale, informacione të detajuara personale dhe aktivitete të ndryshme në situata të ndryshme). Më pas mësimdhënësi/ja paraqet një shembull të një profili të rremë dhe vë në dukje shenjat që tregojnë se profili është i rremë (fotot e fytyrave mungojnë, simbolet ose fotot e diçkaje tjetër përdoren në vend të fotove të fytyrave, mungon informacioni personal, ka mospërputhje në përmbajtjen dhe renditjen kronologjike të postimeve dhe informacionit). Më pas mësimdhënësi/ja prezanton një sërë profilesh në rrjetet sociale dhe pas çdo profili të paraqitur nxënësit të ndarë në grupe përcaktojnë nëse është i vërtetë apo i rremë dhe tregojnë shenjat përmes të cilave kanë bërë njohjen. Së fundi, diskutohet përse shërbejnë profilet e rreme. (p.sh. ruajtja e anonimitetit, mbledhja e informacionit të fshehtë, joshja e njerëzve, mashtrimi i të tjerëve, ngacmimi kibernetik) dhe si mund të kontrollohet vërtetësia e një profili të caktuar në kushte kur shenjat identifikuese nuk janë aq të dukshme (p.sh. duke verifikuar identitetin përmes platformave të tjera, duke këmbëngulur për një kërkesë miqësie).
- Mësimdhënësi/ja shpjegon se çfarë janë robotët e rrjeteve sociale (softuer që kryen automatikisht detyrat në internet) dhe tregon disa robotë në rrjetet sociale të cilët mund të postojnë në mënyrë automatike, të pëlqejnë ose të ndjekin vazdimisht përdoruesit, por gjithashtu edhe të rrisin artificialisht numrin e ndjekësve, të përhapin lajme të rreme ose të ndikojnë në opinionin publik. Nxënësve, të ndarë në grupe, u kërkohet të hulumtojnë dhe të gjejnë shembuj konkretë se kur robotët kanë qëllime të dobishme (siç janë "chat-bots" që u ofrojnë informacion përdoruesve)

dhe kur janë keqdashës/mashtrues (siç janë robotët (bot-ët) e lajmeve të rreme). Pasi të gjitha grupet të kenë shpërndarë atë që kanë punuar, në një diskutim të hapur përcaktohet se si njihen robotët (përmes një fotografie profili të rremë, nga numri joreal i ndjekësve në krahasim me numrin e aktiviteteve, nga postimet me përmbajtje të rreme, nga komentet e palogjikshme, nga shpërndarja e reklamave) .

- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet detyrë të gjejnë reklama me foto burrash dhe/ose grash (në internet, në televizion, në revista, në afishe etj.) dhe të identifikojnë karakteristikat e jashtme të përbashkëta të grave/ burrave të paraqitur në reklama. Pas prezantimit të punës së grupeve, zhvillohet një diskutim i hapur për pyetjet (veçmas për burrat dhe veçmas për gratë): *Cilat karakteristika përsëriten më shpesh? Të cilës moshë, më shpesh janë personazhet? Çfarë mesazhesh përcjellin në lidhje me pamjen fizike? Çfarë stereotipesh krijojnë për përsosmërinë e trupit mashkullor dhe femëror?*, me qëllim që të arrihet në përfundimin se personazhet në reklama (kryesisht me trupa të përsosur, me imazhe të stolitura dhe me filtra, me pamje dhe në poza joshëse) përfaqësojnë ideale të bukuri që nuk korrespondojnë me shumëllojshmërinë e formave të trupit mashkullor dhe femëror në realitet dhe janë të paarrtshme për shumë njerëz. Më pas diskutohet: (1) rëndësia e pamjes fizike (Sa e rëndësishme është pamja e jashtme për të rinjtë dhe pse?); (2) si pasqyrohet imazhi ideal i krijuar për trupin mashkullor dhe femëror në postimet që të rinjtë publikojnë në rrjetet sociale (Çfarë imazhe postojnë më shpesh të rinjtë? Cilat janë pozat, aktivitetet e tyre në imazhet e postuara?) dhe bashkërisht arrihet në përfundimin se imazhi ideal i trupit mashkullor dhe femëror i krijuar nga media ndikon në formimin e imazhit të trupit tonë.
- Nxënësitt, të ndarë në grupe, hulumtojnë profile të ndryshme të mediave sociale (Instagram, Facebook, Twitter, etj.) të yjeve të njohura të pop-it për sa i përket mënyrës sesi promovojnë idealet e trupit mashkullor dhe femëror, duke marrë parasysh imazhet, titrat dhe komentet në postime. Më pas, secili grup përgatit një prezantim me shembuj që ilustrojnë se çfarë lloj mendimesh, ndjenjash dhe veprimesh ngjall tek të rinjtë imazhi ideal i trupit të treguar. Pas prezantimit të punës, në një diskutim të hapur nxënësit ndajnë vëzhgimet, idetë dhe mendimet e tyre se si idealet e trupit në rrjetet sociale ndikojnë në vetëvlerësimin dhe mirëqenien e të rinjve (Çfarë bëjnë të rinjtë për të pasur të njëjtin trup si ai ideal? A konsiderohen të shëndetshme të gjitha veprimet e tilla? Si ndihen ata që nuk kanë një trup ideal? Çfarë mendojnë të tjerët për ta dhe si reagojnë ndaj tyre?) për të arritur në përfundimin se një imazh negativ për trupin e vet të rinjtë mund të shkaktojë ndjenjë pasigurie, zhgënjim në vetvete, tërheqje në vetvete dhe madje edhe depresion. Më pas, nxënësit, brenda të njëjtave grupe, hulumtojnë strategji të ndryshme për përbalimin e presionit që bëjë mediat në lidhje me imazhin e trupit dhe përgatisin afishe (me fotografi, citate dhe mesazhe mbështetëse) që përfaqësojnë idetë e tyre për vetëvlerësimin dhe mirëqenien e shëndetshme. Fillimisht ua prezantojnë afishet shokëve të klasës dhe më pas i ekspozojnë (në klasë ose në sallë apo në korridorin e shkollës).
- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin nga gjashtë lista secila me përmbajtje të mediave të shkruara (të shkarkuara nga interneti), të destinuara për: informim (lajme), për paraqitjen e opinionit të dikujt, për reklamim, për reklamim social (si të silleni), për marrëdhënie me publikun dhe për propagandë. Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë llojet e përmbajtjeve mediatike dhe kërkon prej nxënësve të përcaktojnë llojin e përmbajtjes së

dhënë përmes diskutimit në grup. Më pas, mësimdhënësi/ja lexon titullin e secilës përmbajtje dhe grupet tregojnë se në cilën kategori kanë vendosur secilën nga gjashtë përmbajtjet. Mësimdhënësi/ja në tabelë, poshtë titullit të secilës përmbajtje, shënon përgjigjet e secili grup. Përmes një prezantimi të shkurtër ai/ajo u shpjegon nxënësve llojet e përmbajtjeve mediatike. Në fund, në një diskutim të hapur, me ndihmën e pyetjeve orientuese të mësimdhënësit/ses (p.sh. *Në përmbajtjen mediatike janë shfrytëzuar fakte apo opinione? Kush e ka krijuar përmbajtjen mediatike? Për çfarë qëllimi është shkruar/krijuar? Çfarë emocionesh ngjall?*) nxënësit perceptojnë ndryshimin midis përmbajtjeve mediatike informuese (raportim mediatik) dhe përmbajtjeve mediatike bindëse (opinion, reklamë, reklamë sociale, marrëdhënie me publikun dhe propagandë).

- Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve komponentët e përmbajtjes mediatike dhe shpjegon se si ato kontribuojnë në arritjen e qëllimit të përmbajtjes mediatike, pra të mesazhit që dërgohet me përmbajtjen e dhënë. Më pas, nxënësit shikojnë një incizim të një reklamë (p.sh. një reklamë për një pije të famshme) me detyrë që nxënësit, të ndarë në grupe, të analizojnë përmbajtjen mediatike bazuar në aspektet e mëposhtme:
 - 1) Autorësia – Kush e ka krijuar përmbajtjen mediatike?;
 - 2) Formatit – Cilat teknika krijuese janë përdorur për të krijuar përmbajtjen mediatike dhe për të tërhequr vëmendjen?;
 - 3) Audienca – Për kë synohet përmbajtja mediatike?; Si interpretohet dhe përjetohet përmbajtja nga njerëz të ndryshëm?;
 - 4) Përmbajtja – Cilat pikëpamje/vlera përfaqësohen në përmbajtjen mediatike?;
 - 5) qëllimi – Për çfarë qëllimi u krijua përmbajtja?.

Më pas secili grup paraqet punën e tij dhe krahasohen përgjigjet. I njëjti aktivitet përsëritet, por në vend të një reklame, nxënësve u jepet të analizojnë një përmbajtje tekstuale mediatike (p.sh., një rubrikë gazete).

- Nxënësve u paraqitet reklamë për një produkt për humbje peshe që pretendon se i ndihmon njerëzit të humbin peshë shpejt dhe lehtë me përpjekje minimale. Reklama duhet të përfshijë foto para dhe pas që "dëshmojnë" efektin e supozuar të produktit dhe dëshmi nga njerëz që pretendojnë se kanë pasur rezultate të jashtëzakonshme duke përdorur produktin e reklamuar. Nxënësve, të ndarë në grupe, u kërkohet të analizojnë përmbajtjen mediatike (autorësinë, formatin, audiencën, përmbajtjen, qëllimi), duke iu referuar veçanërisht pyetjeve: (1) *Cili është qëllimi i fotografive? Si mund të bëhen ato?* (2) *Sa reale janë premtimet e bëra në reklamë? Sa mund t'u besohet dëshmive?* (3) *Sa të thjeshta shfaqen efektet e produktit? A ka prova të vërteta shkencore që konfirmojnë efektet?* Pas një prezantimi të punës së bërë nga të gjitha grupet, diskutohet sesi nëpërmjet qëndrimeve të njëanshme, ata mund të njohin përmbajtjen propaganduese dhe manipuluese në mesazhet mediatike.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi/mësimdhënësja siguron gjithëpërfshirjen e secilit nxënës në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai/ajo mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë të shkollave me qendra burimore). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi/mësimdhënësja trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi/mësimdhënësja përpaket të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxisin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi/mësimdhënësja përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të bëjë vlerësim të përvojave, njohurive dhe aftësive të mëparshme të nxënësve, të ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi i përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- parashtrimin e pyetjeve dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- ushtrimet kontrolluese dhe përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- punimin e projekteve;
- detyrat dhe veprimtaritë hulumtuese gjatë të cilave nxënësi kryen: mbledhjen e të dhënave, evidentimin, paraqitjen e rezultateve - në mënyrë narrative ose me tabela, me diagrame ose me grafikë dhe prezantimin e tyre;

- punimet praktike (p.sh. të shkruarit/krijimi i teksteve sipas kërkesave të ndryshme, analiza dhe interpretimet e teksteve letrare, analiza gramatikore e tekstit, demonstrime, skema, ilustrime, prezantime etj.);
- raporte të shkruara me të dhëna nga hulumtimet e kryera.

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr notë sumative (përmbledhëse) të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me vlerësimin e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2024/2025	
Institucioni/bartës i programit mësimor	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën VII.</p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик</i> за VII одделение.</p>	<p>бр. 12-12122/8 8.11.2023 година</p>	<p>Министер за образование и наука, Doc. Dr. Jeton Shaqiri, с.р.</p> <hr/>